

Prof. dr. Ali MUKA
etnolog

NJË MONOGRAFI KUSHTUAR OBJEKTEVE TË KULTIT MUSLIMAN

(shkruar nga Prof. dr. Aleksandër Meksi)

Këto ditë doli nga shtypi dhe u vu në qarkullim një monografi e re nga fusha e studimeve të historisë së arkitekturës shqiptare, që i kushtohet një gjinie të caktuar të kësaj arkitekture, *xhamive*, të ndërtuara nga *shek. XV* e deri në *shek. XIX*. Ndërtimi i këtyre faltoreve të besimit musliman, në një periudhë historike jo të shkurtër, së bashku me gjini të tjera të ruajtura, kundruar si dukuri arkitektonike, formojnë një tablo me interes për kohën. Siç theksohet në libër, ndër monumentet e kultit musliman që trashëgojmë nga e kaluara, xhamitë zënë vendin kryesor për nga numri, vlerat e përhapja. Po ashtu, ndryshe nga gjini të tjera ndërtimore të së njëjtës periudhë, për to ka krahasimisht më shumë të dhëna, botime nga studiues e udhëtarë bashkëkohës dhe dokumentacion arkivor.

Libri ka për autor *prof.dr. Aleksandër Maksin*, një historian i njohur i arkitekturës që trashëgojmë nga e kaluara. A. Meksi, së bashku edhe me kolegë të tjerë, ka dekada që është angazhuar në *gjurmimin, dokumentimin, mbrojtjen e restaurimin* e monumenteve të arkitekturës në Shqipëri, veçanërisht me ato të kultit.

Vepra, përveç *Hyrjes* (f. 7-10) dhe aparatit ndihmës e plotësues në fund, strukturohet në *katër krerë*, ku secili prej tyre ndalet në aspekte të caktuara e konkrete, të lidhura me dukurinë kryesore të marrë përsipër. *Kreu I* (f. 11-37), me titull *Rrethanat historike (shek. XV-XIX) dhe arkitektura e xhamive*, gjithsej 27 faqe, përfshin katër harta grafike të Shqipërisë, ndër të cilat, e dyta hedh dritë për fundin e *shek.*

XV, e treta për fundin e *shek. XVI*, ndërsa e katërta për *shek. XVII*. Karakterin shkencor të detyrës së marrë përsipër në këtë kapitull, ia konfirmojnë edhe 66 *fusnota* të sjella në fund të tij, ku përfshihen vepra e studime të mbi 30 autorëve (disa më shumë se një herë), dhe 8 botime me autorësi kolektive. Në këtë tablo historike të shkurtër, por domethënëse nga përmbajtja, hidhet dritë mbi dukuri, të tilla si: vendosja e pushtimit osman dhe e administratës pushtuese, rezistenca e shqiptarëve në *shek. XV*, procesi i islamizimit, rimëkëmbja ekonomike dhe ndërtimi i faltoreve të fesë së re në këto troje..

Xhamitë në fillim takohen në qendra ku ishte reale prania e turqve. Në *shek. XVI*, ka rritje të ndjeshme të rolit ekonomik e shoqëror të qyteteve e të numrit të banorëve, por dhe në fshatra, siç dëshmojnë Regjistra të kohës. Rrjedhimisht, edhe ndërtimi i faltoreve islame nuk qe kudo i njëkohshëm. Kështu, xhamitë e para u ndërtuan për t'u shërbyer garnizoneve e administratës osmane; janë ngritur me nxitim e pa pretendime, shpesh duke shndërruar kisha në xhami, prandaj dhe deri në ditët tona, prej tyre kanë arritur vetëm pak shembuj, të gjitha të tipit me sallë të mbuluar me çati druri.

Nëse ndërtimi i xhamive të para ndodh në fund të *shek. XV*, më tej zhvillimi e ndërtimi i tyre kalon nëpër një rrugë të gjatë, e cila mbyllet në çerekun e parë të *shek. XIX* me Rilindjen Kombëtare. Gjatë *shek. XVI-XVII*, ato ndërtohen në pjesën më aktive të qendrave qytetare, pranë tregjeve e ndërtimeve publike të tyre, si ndërtime të veçanta ose komplekse (Berat, Delvinë, Gjirokastrë, Elbasan). Po ashtu, krahas *xhamive* në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, ngrihen edhe *mesxhide*; ndërsa në të parat kryhet shërbimi fetar i së premtës dhe kanë *minber*; të dytat, janë më të vogla, ndërtohen me materiale të varfra dhe mbulohen gjithnjë me çati druri e tjegulla.

Kreu II (f. 38-106), me titull *Xhamitë me sallë të mbuluar me kupolë*, gjithsej 69 faqe, më voluminozi i të gjithë monografisë, përfshin 29 paraqitje grafike (ku vend me rëndësi zënë planimetri të xhamive të ndryshme) dhe 51 fotografi bardhezi (kryesisht pamje të jashtme e ndonjë interier). Krahas tyre, të gjitha në rolin e dokumentit autentik, analiza shoqërohet me 97 *fusnota*, ku përmenden botime të mbi 27 autorëve, shumica

të huaj. Lexuesi i interesuar mëson se shembuj të këtij tipi xhamish janë ndërtuar çdo herë me pretendime nga ana e dhuruesve ose e porositësve të tyre, si dhe nga bashkësia fetare. Si tip arkitekturor, ai takohet për herë të parë në Stamboll dhe i përket periudhës klasike të arkitekturës turko-osmane. Në kapitull sillen, në rend kronologjik, 16 shembuj konkretë të studiuar nga vetë autori e nga të tjerë; shembulli i parë i përket xhamisë së Iljaz Bej Mirahorit në Korçë, ndërsa i fundit, xhamisë së Peqinit. Për secilën, shoqëruar me paraqitje grafike e fotografi, jepet: *arkitektura, të dhëna historike, raporte krahasuese me xhami të tjera dhe datimi*.

Kreu III (f. 107-143), me titull *Xhamitë me sallë të mbuluar me çati druri*, gjithsej 37 faqe, përfshin 20 paraqitje grafike (planimetri, prerje e pamje) dhe 35 fotografi bardhezi, të një formati normal dokumenti të lexueshëm saktë e qartë (dukuri që qëndron për të gjithë materialin grafik e fotografik të monografisë). Mëson se ky tip takohet në një numër shumë më të madh se i pari, sidomos në fshatra e në brendësi të lagueve në qytete. Edhe këtu shqyrtohen 16 shembuj konkretë, secili i shoqëruar me paraqitje grafike e fotografi; fillohet me xhaminë në Kalanë e Shkodrës dhe mbyllet me xhaminë në Lezhë, ku si e tillë është kthyer kisha e Shënkollit. Analiza shoqërohet me 52 *fusnota*, ku përmenden publikime të mbi 18 autorëve. Shembuj të këtij tipi, mjaft i përhapur në Shqipëri, takohen të zgjidhjeve modeste e të përmasave të vogla, por dhe me arritje në vështrim arkitektonik. Edhe këtu, shembujt paraqiten në rend kronologjik në vështrim ndërtimor, ku nuk mungojnë krahasime me xhami të tjera, brenda vendit e në arealin ballkanik, përfshirë dhe datimin. Xhamitë e para të këtij tipi kanë salla me shumë kolona si dhe *xhamitë selxhukide*, xhamitë e mëdha (*uluxhami*), të cilat, gjatë periudhës së principatave selxhukide, ndjekin rrugën e thjeshtimit të hapësirës së brendshme, nëpërmjet zvogëlimit të numrit të kolonave. Pra, këtij tipi i përketin dhe xhamitë e para të ndërtuara prej turqve në vendin tonë.

Kreu IV (f. 144-157), me titull *Karakteristika të përgjithshme të arkitekturës së xhamive të Shqipërisë*, gjithsej 14 faqe, përfshin 8 foto bardhezi e 11 *fusnota*, që e integrojnë shqyrtimin me

studime të botuara nga autori dhe nga të tjerë. Nëse kapitulli i parë synon një tablo relativisht të gjerë të kushteve ku filluan e vazhduan të ndërtohen këto objekte kulturi, dy krerët në vazhdim, fokusojnë respektivisht dy tipe kryesore xhamish të përhapura te ne, ndërsa kapitulli i fundit është një vështrim përmblyës lidhur me dukurinë e marrë përsipër. Madje vetë autori, këtë kapitull e konsideron si një sprovë, mbështetur edhe në arritje të autorëve të tjerë, ku jepen gjykime për ndërtimin, shtrirjen, nivelin, zhvillimin në kohë të xhamisë, vendin që zë e lidhjet me gjini të tjera të arkitekturës, elementë të veçanta të formës, pa harruar zbulimoret, teknikën dhe mjeshtrit e ndërtimit. Del e qartë se, nga të dy grupet tradicionale xhamish, në vështrim tipologjik, në raport me ato me sallë unike të mbuluar me kupolë, xhamitë e tipit me sallë që mbulohet me çati druri e tjegulla, janë më të vjetrat (Elbasan, Shkodër, Berat); ndërsa xhamia e parë e mbuluar me kupolë është ajo e Mirahorit në Korçë (1496). Gjithsesi, në çdo rast, zgjedhja e tipit ishte në vartësi të kërkesave e mundësive ekonomike të porositësit a të bashkësisë fetare, pa harruar dhe aftësi të ndërtuesit.

Praktikisht, modelet u morën nga prototipa të ndërtuar në Turqi, sipas formave tradicionale të ndërtimeve islame. Ato fillimisht u prunë nga turqit e u ndërtuan nga vendasit nën drejtimin edhe të arkitektëve të huaj, të ardhur me porosi, pasi vendasit nuk e njihnin tipologjinë e kësaj arkitekture. Ndërsa më tej ato zënë vendin e vet në tërësinë e ndërtimeve të kohës në këto troje, duke marrë fizionomi e nota origjinale vendase, me tipologji të qartë. Pra, në mënyrë graduale, këto ndërtime afrohen me ndërtimet e tjera, marrin gjithnjë e më tepër elemente arkitekturore; duke krijuar afri me arkitekturën e ndërtimet vendase. Fjala vjen, ndërtimi i çative prej druri pati ndikim nga arkitektura popullore, sidomos në fshat, do të shtonim ne. Prandaj dhe xhamitë e vogla e *mesxhidet* u dalluan nga banesat vetëm nga minaret e portikët. Ndërsa për xhamitë me kupolë, ndonëse qysh nga ajo e Mirahorit (Korçë), vazhduan të ndërtohen sipas po atij modeli të arkitekturës së vjetër turko-osmane, *shembujt e ndërtuar te ne, si prototipa për xhamitë e këtij tipi, formuan, një sërë tiparesh, që duhen konsideruar*

traditë. Dhe për sa më sipër, autori na kujton dukuri të tilla konkrete, si: vëllimi, tamburet e ulëta, portiku, lirësia në organizimin e brendshëm etj. Po ashtu, pavarësisht se, në pamjet e jashtme, rol të rëndësishëm kanë luajtur minaret, të cilat u bënë element karakteristik i qendrës ku përfshihej xhamia, nuk duhet lënë në harresë trajtimi dekorativ. Në këtë aspekt, xhamitë e vendit tonë i shmangen monokromisë së atyre turko-osmane. Fjala vjen, përdorimi i pikturës murale (Tiranë, Berat), i portikëve me dritë-hijen e tyre (Tiranë, Kavajë, Berat, Peqin, Elbasan), i afrojnë xhamitë më shumë me arkitekturën e kohës. Po ashtu, brendësia e faltoreve më të spikatura trajtohet me shumë dritë, shpesh e pikturuar me motive bimore në të gjitha muret ose vetëm në kupolë e në *mihrab*. Vëmendjen ta tërheq, gjithashtu, kompozimi e trajtimi dekorativ i elementeve prej druri, si: *mafili*, *minberi*, kolonat e brendshme e tavanet. Natyrisht, këtu duhet mbajtur parasysh që elemente, të tilla si: *minaret*, *mihrabet*, *mafilet* janë realizuar, në thelb, sipas skemave e formave tradicionale të arkitekturës muslimane.

Lidhur me teknikën e ndërtimit të mureve dhe të strukturave mbajtëse, autori vëren se në faltoret e fundit të *shek. XV*, përdoren teknika dhe elemente të njohura nga ndërtuesit vendas, në arkitekturën e *shek. XI-XV*, si: kupolat e qemeret, kornizat dhëmbësharre, harqet e shkallëzuara nëpër dritare dhe, mbi të gjitha, teknika e ndërtimit me gurë e tulla i mureve të jashtëm, që përdorej rrallë në Turqi. Këto hasen si në qytete, ashtu dhe në fshatra. Ndërsa nga gjysma e dytë e *shek. XVII* e deri në *shek. XIX*, kjo teknikë zëvendësohet nga ajo e zakonshme e murit me gurë. Guri, në ndërtime me rëndësi, përpunohet e skalitet duke i dhënë forma të rregullta kuadratike, ndërsa në xhami të ndërtuara me gur të papërpunuar muret suvatohen e lyhen me gëlqere. Po ashtu, në këtë fazë futen elemente të reja strukturore, si: harqet e *mprehta* dhe ata në formë *fundlundre*; trompat parabolike në qoshe, stalaktite pranë trompave dhe në *mihrabet*. Sikundër dihet, harqet *fundlundre* janë shenjë dalluese e arkitekturës turko-osmane. Ky hark më tej zëvendësohet me atë rrethor, i cili takohet edhe në ndërtime popullore, përveç në ato të

kultit të krishterë, e në ndërtime mbrojtëse a inxhinierike. Kjo tablo e shkurtër dëshmon se në këto troje ka pasur mjeshtër e atelie vendase. Kështu, dihet, fjala vjen, se ndërtuesit ishin të organizuar në *atelie* e në *esnafe*, që, në disa raste, drejtoheshin nga arkitektë të mirëfilltë ose nga agai i ndërtimeve.

Në monografi del e qartë se këto ndërtime zënë një vend të rëndësishëm në arkitekturën shqiptare. Ato janë ngritur në të gjitha trevat e banuara nga shqiptarët gjatë shekujve XV-XIX, duke mbetur dëshmi të qarta të një periudhe mjaft domethënëse në historinë e këtij populli. Lexuesi i interesuar merr informacion për studiues që gjurmuan në terren, dokumentuan e studiuuan këto monumente kulti, ku spikasin, në mënyrë të veçantë, dhjetëvjeçarët e fundit të *shek. XX*, për çka lexuesi njihet dhe me emra konkretë, në radhët e të cilëve hyn padyshim dhe vetë autori i kësaj monografie. Artikujt e shumtë për monumentet e punimet e restaurimit në to, përbën një realitet, i cili e ka nxitur atë për botimin e kësaj monografie. Përveç vlerësimit të punës së kryer nga këta studiues, autori thekson me të drejtë që, *si burim i themeltë*, për studiuesit shqiptarë të arkitekturës së xhamive, mbetet puna e palodhur e të ndjerit Vexhi Buharaja, lidhur me mbishkrimet turko-arabe të Shqipërisë, e pabotuar në mënyrë të plotë e shteruese. Autori konsideron si ndihmesë të rëndësishme në studimin e këtyre ndërtimeve edhe shënime të udhëtarëve të kohës, të cilët kanë vizituar trevat shqiptare. I pari, dhe më i rëndësishmi ndër ta, është udhëtari turk E. Çelebi, vëllimi VIII i veprës së të cilit, me titull "*Sejjahatname*", përmban informacione të shumta për jetën, njerëzit e ndërtimet nga viset shqiptare që ka shkelur. Madje, A. Meksin e shqetëson fakti që, *për fat të keq, besoj se jemi vendi i vetëm që nuk ka një botim të plotë e shkencor të pjesës përkatëse të veprës në fjalë*; ndonëse, na kujton ai, diçka është nxjerrë në dritë nga një botim i vitit 2000 (në gjuhën angleze), prej R. Dankoff e R. Elsie, ku bëhet fjalë edhe për Kosovën, Malin e Zi dhe Ohrin. Po ashtu, autori me të drejtë konsideron *një minierë ende e pashfrytëzuar gjer në fund*, arkivat turke; pa harruar edhe AQSH, tek i cili ruhen, gjithashtu, dokumente me interes për këtë temë.

A. Meksi vlerëson ndihmesën e rëndësishme që ka dhënë

edhe holandezi M. Kiel, i cili pati privilegjin të njëjhte në vite monumentet e kësaj gjinie të vendeve të tjera, përfshirë dhe botimet. Punimet e tij të ndihmojnë, fjala vjen, në aspekte, të tilla si vendosja në kohë dhe inkuadrimi i tyre në tërësinë e arkitekturës osmane, duke theksuar se *monografia e tij për arkitekturën osmane në Shqipëri do të jetë, për mjaft kohë, në themel të studimeve shqiptare*. Meksi nuk lë pa përmendur edhe E. Hakki Ayvendi, i cili, në vëllimin IV të punimit madhor “Ndërtimet turke në Europë”, përcjell të dhëna të shumta për Shqipërinë, të cilat duhen shfrytëzuar krahas arkivave.

Në mbyllje të këtyre shënimeve modeste, po ndalem te ndonjë tipar thelbësor të kësaj monografie:

1. Studimet e derisotme, përfshirë dhe librin që kemi në dorë, janë një kontribut me vlerë; ato, të marra së bashku, plotësojnë tablonë njohëse të arkitekturës së shek. XV-XIX, flasin për shkallën e zhvillimit të kësaj arkitekture e nivelin e mjeshtërive të ndërtimit. Ato dëshmojnë se edhe xhamitë, si ndërtime të kultit musliman, janë pjesë natyrore e arkitekturës sonë mesjetare, mbeten krijimtari autentike e popullit shqiptar.

2. Me gjithë arritjet, studiuesve të fushës u qëndrojnë përpara probleme, të tilla si: nevoja e ngutshme e shtrirjes së gjurmimeve e studimeve në të gjitha trevat e banuara nga shqiptarë, çka do të çonte në nxjerrje përfundimesh tërësore e jo për një trevë të kufizuar. Po ashtu, duhen zgjeruar e thelluar kërkimet, përveç në AQSH, edhe në arkiva të Turqisë, ku do të mund të siguroheshin të dhëna për aspekte, të tilla si: lejet e ndërtimit, porositësit e ndërtuesit, ndikime e lidhje me kryeqendrën e me provinca të tjera. Edhe botimi me kritere shkencore i veprës “Mbishkrimet e ndërtimeve turko-arabe në Shqipëri”, i Vexhi Buharasë, apo vazhdimi i botimit të Regjistrave të popullsisë, dhe i atyre të taksës së *xhizjes*, shënojnë një ndihmesë tjetër për thellimin e studimeve të deritanishme. Një moment të rëndësishëm përbën edhe nevoja e njohjes më mirë të veprave të arkitektëve shqiptarë në Perandorinë Osmane, e kontributit të këtyre arkitektëve e ndërtuesve, qoftë në atdheun e tyre, ashtu dhe në qendra të asaj Perandorie, përfshirë, veç arkivave, edhe botime të reja

e ende të panjohura.

3. Së bashku me përkujdesje e vlerësim më të mirë të xhamive që ruhen, vëmendje i duhet kushtuar edhe kuadrit specialist të nevojshëm, kualifikimit e trajtimit të organizuar të tij, në përputhje me kohën e kërkesat e saj, madje jo vetëm në këtë e për këtë fushë të trashëgimisë sonë. Vetëm kështu do të ruhej e konsolidohej vazhdimësia gjurmuese e studimore, do të vazhdohej të hidhej më shumë dritë mbi identitetin tonë kulturor si popull e si komb.